



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Vendim nr. 385/1

“Mbi korrigjimin e vendimit nr. 385, datë 18.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Flojera Davidhi”

Pamela Qirko	Kryesuese
Etleda Çiftja	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ”, sipas të cilit përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

Trupi gjykues u mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes znj. Etleda Çiftja, për korrigjimin gabimit material në vendimin e subjektit të rivlerësimit Flojera Davidhi:

Në vendimin e arsyetuar të subjektit të rivlerësimit znj. Flojera Davidhi, i cili iu dërgua palëve respektive, subjektit të rivlerësimit, përfaqësuesve të ONM-së dhe Komisionerëve Publikë, në dispozitivin e vendimit konstatohet se është bërë një gabim material, konkretisht pika 2, faqja nr. 27: “Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë pranë organit kompetent për inspektim nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore çështjen me numër regjistri themeltar 170/1255, përfunduar me vendimin nr. 373, datë 1.4.2019”, ndërkohë që duhet të jetë “Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë pranë organit kompetent për inspektim nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore çështjen me numër regjistri themeltar 58212-01049-41-2019 (373), përfunduar me vendimin nr. 340, datë 3.7.2019.”

Trupi pasi konstatoi se kërkesa e relatorit qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e një gabimi material,

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 385, datë 18.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të subjektit të rivlerësimit znj. Flojera Davidhi, i cili iu dërgua palëve respektive, subjektit të rivlerësimit, përfaqësuesve të ONM-së dhe Komisionerëve Publikë, në dispozitivin e vendimit është bërë një gabim material, konkretisht pika 2, faqja nr. 27: “Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë pranë organit kompetent për inspektim nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore çështjen me numër regjistri themeltar 170/1255, përfunduar me vendimin nr. 373, datë 1.4.2019”, ndërkohë që duhet të jetë “Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të transferojë pranë organit kompetent për inspektim nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore çështjen me numër regjistri themeltar 58212-01049-41-2019 (373), përfunduar me vendimin nr. 340, datë 3.7.2019.”
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerët Publikë dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim.
3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleđa Çiftja

Relatore

Pamela Qirko

Kryesuese

Roland Ilia

Anëtar

Sekretare gjyqësore

Resilda Bilaj